



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**V E N D I M**

**Nr. 49 Datë 21.03.2007**

**Për**

**Rekomandime të ndryshimeve në disa akte normative në fushën e sigurimeve**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali Zv/Kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.03.2007, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Kufizimin e konkurrencës, si rezultat i disa barrierave administrative të vendosura nëpërmjet akteve nënligjore në ligjshmërinë e sigurimeve të detyrueshme motorrike.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, nenet 24, shkronjat d dhe f.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Raportit të Grupit të Punës të datës 9.3.2007, Relacionit të Sekretares së Përgjithshme bashkëlidhur këtij raporti, pas dëgjimit të palëve objekt hetimi, dhe pasi dëgjoi në një seancë konsultative Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare, si dhe administrimit të akteve shkresore

**V Ë R E N S E:**

1. Tregu i sigurimit të detyrueshëm në nivelin e tregtimit për Policën Kufitare shfaqet si një treg me një tregtues të vetëm me pakicë. UDSA tregon policën e sigurimit për llogari të tetë shoqërive të sigurimi: Sigal, Sigma, Atlantik, Intersig, Interalbanian, Albsig, Eurosig dhe Insig).
2. Ndarja e të ardhurave nga shitja e policës së sigurimit kufitar, bëhet me Urdhër të Ministrit të Financave, bazuar në pjesën e tregut për TPL-në, që zë çdo shoqëri në tregun e sigurimit të detyrueshëm në vitin financiar paraardhës.

3. Tregu i sigurimeve është jo plotësisht i liberalizuar. Aktet nënligjore, të dala nga Ministri i Financave përcaktojnë kufirin minimal dhe maksimal të primit të pastër të sigurimit të detyrueshëm dhe elementë të tjerë lidhur me shitjen dhe administrimin e policave të sigurimit.
4. Polica e sigurimit të detyrueshëm kufitar shitet me të njëjtin çmim nga agjenti i kontraktuar UDSA për tregtimin e këtij shërbimi.
5. Aktet nënligjore të Ministrit të Financave “Mbi shitjen dhe Administrimin e Policave të Sigurimit Kufitar nga Byroja Shqiptare e Sigurimit” që:
  - formalizojnë një marrëveshje me objekt dhe pasojë kufizimin e konkurrencës;
  - i japin fuqi BSHS-së për të lidhur kontratë me një agjent të vetëm
  - shkaktajnë përqëndrimin e këtij tregu në nivelin e shitjes/tregtimit;
 janë jashtë kompetencave të përcaktuara në ligjin Nr. 8729, datë 18.1.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 7641, datë 1.12.1992 “Për miratimin me ndryshime të Dekretit Nr 295, datë 15.9.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike, për përgjegjësinë ndaj palëve të treta” dhe statutin për funksionimin e B.SH.S.
6. Ofrimi i shërbimit/shitjes së Policës Kufitare është deformuar nga zbatimi i Urdhërit Nr.14, datë 6.5.2005 “Mbi shitjen dhe Administrimin e Policave të Sigurimit Kufitar nga Byroja Shqiptare e Sigurimit” të Ministrit të Financave. Ky urdhër ka dalë në devijim nga Ligji Nr. 8729, datë 18.1.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 7641, datë 1.12.1992 “Për miratimin me ndryshime të Dekretit Nr 295, datë 15.9.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike, për përgjegjësinë ndaj palëve të treta” si dhe statutit të BSHS-së.
7. Ky devijim ligjor, ka vijuar me shkresën miratuese të Ministrit të Financave Nr. 3188/5, datë 23.6.2005 “Për miratimin e rregullores “Mbi administrimin e emetimit, prodhimit dhe shitjes së policës së sigurimit kufitar”.
8. Urdhëri Nr. 25, datë 26.6.2006 i Ministrit të Financave bën disa rregullime të pjesshme të Urdhërit Nr 14, datë 6.5.2005 “Mbi shitjen dhe Administrimin e Policave të Sigurimit Kufitar nga Byroja Shqiptare e Sigurimit”, por tregu përsa i takon ofrimit dhe tregtimit të policës së sigurimit kufitar realizohet nga një agjent i vetëm.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, shkronjat d dhe f, të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”

## **REKOMANDON:**

### **A. Ministrit të Financave:**

1. Shfuqizimin e plotë të Urdhërit Nr. 14, datë 6.5.2005 të Ministrit të Financave “Mbi shitjen dhe administrimin e policës kufitare nga BSHS” dhe urdhërave të tjerë në zbatim të tij, që lidhen me shpërndarjen e të ardhurave nga shitja e policës kufitare.
2. Shfuqizimin e Urdhërit Nr. 25, datë 26.6.2006 “Për disa ndryshime në Urdhërin e Ministrit të Financave Nr.14, datë 6.5.2005 “Për shitjen dhe administrimin e policave të sigurimit kufitare nga Byroja Shqiptare e Sigurimit”.
3. Procedura për emetimin, administrimin e policave të sigurimit të detyrueshëm që realizohet nga BSHS, të mbikqyret nga AMF.
4. Rishikimin e ligjit Nr. 7641, datë 01.12.1992 “Për miratimin me ndryshime të Dekretit Nr.295, datë 15.09.1992 “ Për sigurimin e detyrueshëm të Mbajtësve të Mjeteve Motorrike për Përgjegjësinë ndaj Personave të Tretë”, me synim liberalizimin (hapjen e tregut për konkurrencë), duke u fokusuar në:  
shfuqizimin e neneve 7 dhe 10 të rregullores për disa shtesa në Rregullore 622/1, datë 15.2.1992 “Për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, ku i jepet e drejta Ministrit të Financave për nxjerrjen e urdhërit periodik “Për miratimin e primit të pastër të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”, pasi bie ndesh me Ligjin Nr.91`21, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
5. Të rishikohet ligji Nr.9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetsimit në sigurime dhe risigurime”, duke vendosur detyrimin ligjor që çdo shoqëri brenda një afati të caktuar kohor, por jo më shumë se 1 vit, të instalojë sistemin on-line.

### **B. Autoritetit Mbikqyrjes Financiare**

Për shmangien e informalitetit në tregun e sigurimeve, Autoriteti përgjegjës për mbikqyrjen e tregut të sigurimeve duhet:

- a) të krijojë një paketë të plotë rregulloresh që lidhen me mbikqyrjen financiare, duke marrë eksperiencën më të mirë të mbikqyrjes së sektorit bankar, si dhe duke respektuar Ligjin 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
- b) Rregullimi i tregut të policave të sigurimit të detyrueshëm, nëpërmjet vendosjes së kontrollit dhe standarteve, si dhe zbatimi i sanksioneve në rastet e shkeljeve të vërejtura.

